REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:039962

Datë: 19.07.2021

Numri i dokumentit: 02009321

C.nr.718 /2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me** gjyqtaren Mirvete Alidema, në çështjen kontestimore të paditëses B.... M..... nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Drenushë Lipovica , avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Spitali i Pëgjithshëm në Gjilan, rruga "Idriz Seferi" nr.10, të cilën e përfaqëson, përfaqësuesi ligjor me autorizim S..... A..... nga Gjilani, me objekt kontesti, pagesa e shpërblimit të pagave jubilare, vlera e kontestit 404.56€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më date 15 Qershor 2021, mori, ndërsa më datën 1 Korrik 2021, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I. MIRATOHET kërkesë padia e paditëses B..... M..... nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune t'ia paguajë shumën prej 404.56€, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedures gjyqësore në shumë prej 259€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja B..... M....., përmes të autorizuarës të saj, në këtë gjykatë më datë 11.03.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e saj dhe të obligohet e paditura që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t'ia paguajë shumën e të hollave prej 404.56€, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e paraqitjes të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, meqë më parë kishte paraqitur kërkesë në organet përkatëse të të paditurës, por një kërkesë e tillë nuk ishte realizuar.

2020:039963

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se paditësja vitin jubilar e kishte pasur në vitin 2011, ashtu që në bazë të nenit 341 pika 2 neni 342 pika 1, ekziston parashkrim pasi që në dispozitë e cekur më lartë, përcaktohet se të gjitha kërkesat parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh pas plotësimit të kushtit me ligj. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar.

Përfaqësuesja e paditëses si në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.06.2021, ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë të dorëzuar në gjykatë më datë 11.03.2020, duke theksuar që paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar te e paditura dhe ka përvojë pune mbi 18 vite, andaj në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale, rrjedh e drejta për të kërkuar kompensimin për shpërblimin jubilar edhe atë: për 10 vite përvojë të punës në vlerë të një page mujore të paditëses në shumë prej 404.56€, ndërsa sa i përket pretendimit të paditurës e cila është thirr në parashkrim, ka deklaruar që duke u bazuar në provat e deponuara në shkresat e lëndës dhe kontrata e punës në emër të mund të vërtetohet se e njëjta është lidhur në bazë të Ligjit të Punës konkretisht nenit 87 të këtij i cili shprehimisht parasheh që "*të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës"*. Gjithashtu e njëjta i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestuese edhe atë në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20 €, në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 € si dhe për një seancë të mbajtur në shumën prej 135 €, gjithsej shumën prej 259€.

I autorizuari ligjor i të paditurës, në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pasi që për paditësen vit jubilar ka qenë viti 2011, atëherë kur paditësja i ka mbushur 10 vjet të përvojës së punës dhe e paditura nuk posedon dëshmi se e njëjta të ketë kërkuar shpërblimin jubilar duke u bazuar në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e që as Marrëveshja Kolektive e as Kontrata Kolektive Sektoriale në të cilën thirret paditësja nuk kanë pas fuqi prapavepruese, e që kushti për kërkesëpadinë e paditëses është kaluar mbi 6 vite, ashtu që në bazë të nenit 341 pika 2 neni 342 pika 1, ka parashkrim të kërkesës, pasi që në këtë dispozitë përcaktohet se të gjitha kërkesat parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh pas plotësimit të kushtit me ligj. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqësore si dhe për ta vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestuese ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Kontrata e punës në kohë të pacaktuar me numër të protokollit 1965 e datës 31.12.2012; Vërtetimi i përvojës së punës me numër të protokollit 01-1993 i datës 22.11.2019, Kërkesa e paditëses adresuar të paditurës me numër të protokollit 01/204 e datës 31.01.2020, Vendimi i të paditurës me numër 01-351 I datës 14.02.2020 me të cilën është refuzuar ankesa e paditëses, Ankesa me nr. 01-437 e datës 25.02.2020, e paditëses adresuar Komisionit të Ankesave në kuadër të të paditurës, Vendimi me numër 01-533 i datës 04.03.2020, me refuzimin e ankesë dhe lënien ë fuqi të aktit administrative si Lista e pagave në emër të paditëses.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se paditësja, është në marrëdhënie pune në Spitalin Regjional të Gjilanit, e punësuar si Infermiere në Poliklinikë të Ortopedisë, në Spitalin të Përgjithshëm në Gjilan, dhe ka përvojë pune mbi 18 vite me kontratë të përhershme dhe vazhdon të punoj edhe më tutje te e paditura, fakt ky i vërtetuar me Kontratën me nr. të protokollit 1965 e datës 31.12.2012.

Nga Vërtetimi i përvojës së punës me numër të protokollit 01-1993 i datës 22.11.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune në cilësinë e Infermieres në Poli klinikë, te e paditura dhe ka përvojë pune 18 vite ku edhe vazhdon të punoj edhe më tutje me kontratë të përhershme pune.

Nga Kërkesa me nr.01/204 e datës 31.01.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësja fillmisht i është drejtuar organeve përkatëse të të padituës për kompensimin e pagave jubilare.

Nga vendimi me numër 01-351 i datës 14.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditëses i është refuzuar kërkesa për pagesë jubilare.

Nga Ankesa me numër 01-437 e datës 25.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësja kishte paraqitur ankesë ndaj vendimit të të padituës për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jot ë plotë të gjendjes faktike.

Nga Vendimi me numër 01-533 i datës 04.03.2020, gjykata vërtetoi faktin se është refuzuar ankesa e paditëses dhe është lënë në fuqi akti administrative i të padituës.

Nga lista e pagave në emër të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paga bazë e paditëses është 377 € ndërsa paga neto e saj është 404.56€.

Gjykata në këtë çështje kontestuese sa i përket të drejtës subjektive të paditëses, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratë Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, konkretisht nenin 4 paragrafi 3 e cila ka hyrë në fuqi nga dt.11.06.2018, në të cilën dispozitë është përcaktuar se *„Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficione /dobitë/ që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të Punës i gëzojnë vetëm anëtarët FSSH-ës*, si dhe nenin 17 pika 3 dhe 4 dhe 5 të po kësaj Kontrate Sektoriale ku potencohet se *"Punëtorët shëndetësorë, në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë për 10 vjet të përvojës së punës në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij, për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore në vlerë të dy pagave mujore të tij dhe për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Punëdhënësi i fundit është që paguan shpërblimin jubilar. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf,* e në rastin konkret pasi që paditësja

2020:039963

ka mbi 10 vite përvojë punë të njëjtës i takojnë një pagë mujore që e ka marre për tre muajt e fundit, andaj vendosi si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, në mbështetje nenit 87 të Ligjit të Punës, ngase Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, ka hyrë në fuqi me datë 18.06.2018, kurse paditësja kërkesën e ka ushtruar te e paditura me datë 31.01.2020, fakt që e konfirmon vet formulari i kërkesës, kurse padinë e ka ushtruar në gjykatë me datë 11.03.2020, çka do të thotë se të drejtën e saj e njejta e ka ushtruar brenda afatit prej 3 vite edhe pse neni 87 i Ligjit të Punës është i paraparës se, citoj ,, *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*, që do të thotë parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e ushtrimit të kërkesës e jo siq duhet të ishte nga dita e ardhjes për pagesë/ maturimi i kërkesës/ të çdo kërkese, e në rastin konkret paditëses një e drejtë e tillë ka filluar t'i takojë që nga hyrja në fuqi e Kontratës Sektoriale të Shëndetësisë.

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi që ta detyrojë të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në lartësi prej 259€ edhe atë: për pagesën e taksës gjyqësore shumën prej 20 €, për përpilim të padisë shumën prej 104€ si dhe për përfaqësim të një séance shumën prej 135 €duke u bazuar në nenin 452.2 të LPK-ës.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 143 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm-divizioni Civil
C.nr.718/20, më datën 1 Korrik 2021

Gjyqtarja,
Mirvete Alidema

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.